

# Format dhe mundësitë e pyetjeve 4.2

Zgjedhja e pyetjeve të mira të cilat zgjojnë interesimin e nxënësve duhet gjithmonë të përgatiten. Janë parakusht i pakalueshëm për një mësim teorik / praktik të suksesshëm. Pyetjet duhet të jenë të qarta, të thjeshta në aspektin gramatikor dhe të shkurtra në aspektin e formulimit.

Format dhe mundësitë më të njohura të pyetjeve janë përmbledhur në vijim:

## Format dhe mundësitë e pyetjeve

Format e pyetjeve	Shembuj	Vlerësimi
Pyetjet e hapura	„Çka mendoni lidhur me mbrojtjen e ambientit?“	Aktivizimi-Nxitje për bashkë mendim dhe qëndrimarrje
Pyetjet e mbyllura	„A do të duhej të inkuadrohen femrat në ushtri ?“	Nuk preferohen, sepse përgjigjet janë me PO ose JO
Pyetjet alternative	„A jeni për apo kundër dënimit me vdekje?“	Të papërshtatshme, nga vetë forma e pyetjes imponohet përgjegjja
Pyetjet aktivizuese	„Si... për ç'shkak... përse... me çka... .. ?“	Shumë të preferuara, sepse zgjojnë interesim, aktivizojnë, kërkojnë përgjigje më të gjata.
Pyetjet vendimtare	„Si do të vendosnit ju?“	Kërkojnë një vendim konkret
Pyetjet logjike	„Nëse kjo është kështu, çka pason pastaj... ?“	Vlerësimi sikurse pyetjet aktivizuese
Pyetjet mbi probleme	„Si e shihni ju problemin e ndotjes së ambientit?“	Kërkojnë një qëndrim lidhur me problemin e caktuar
Pyetjet zingjimore	„Kush çka duhet, kur dhe ku të bëhet?“	Të refuzohen, sepse shumë nënpyetje në kuadër të një pyetje
Pyetje sugjестive	„Me siguri se juve u fle në zemër mirëqenia e familjes suaj?“	Të refuzohen sepse sugjerojnë dhënien e përgjigjes
Pyetjet konfirmuese (Pyetjet harmonizuese)	„Muzikë e këndshme, apo jo?“	Vlerësim i njëjtë si tek pyetjet sugjестive
Pyetjet banale	„Si quhet vendi prej ku fluturojnë aeroplanët?“	Të refuzohen, sepse primitive, përgjegjja gjindet në vetë pyetjen
Pyetje mirëbesimi	„A keni borxhe?“	Të refuzohen, sepse janë jo të tolerueshme dhe nuk shërbejnë për qëllime të shkollimit
Pyetjet retorike	„E dini se çka do të thotë të jeni mësues / instruktor në ditët e sotme“	Një pyetje prej së cilës askush nuk pret përgjigje

## Disa rregulla lidhur më teknikën e drejtë të pyetjeve

- Fjala pyetëse i takon fillimit të fjalisë!
- Gjithmonë duhet të shtrojmë pyetje pozitive!
- Në princip, pyetje duhet parashtruar të gjithë nxënësve!
- Pyetjeve zingjirore duhet ikur!
- Pyetjet sugjestive janë të pavlerë!

## Sjellja gjatë përgjigjeve të ndryshme

### 1. Përgjegjja e saktë:

- Mospërsëritja e përgjigjeve
- Mos të jipen lavdata gjatë gjithë kohës, por vetëm për arsye të zgjimit të interesit ose në rast të ndonjë përgjigje të shkëlqyeshme

### 2. Përgjigjet pjesërisht të sakta:

- Integrimi i të saktës në shprehjet e të menduarit
- Shtrimi i pyetjeve të reja - plotësuese
- Udhëheqja e ndonjë bisede
- Korigjimi eventual i formës së pyetjeve

### 3. Përgjigjet e gabuara apo që mungojnë:

- Ndërmjetësimi i shkaqeve
- Drejtimi i pyetjeve edhe ndaj nxënësve të tjerë
- Të mos qortohet
- Eventualisht sqarim më të përafërt të pyetjes



*Kenë gjithmonë parasysh se,...*

*„Përgjigjen më të mirë e merr ai i cili ka parashtruar pyetjen më të qartë“*

## Pyetjet e mësimdhënësit duhet të jenë të kuptueshme

- Mbështetja në gjuhën e nxënësit
- Qartësia
- Thjeshtësia gramatikore
- Shkurtësia e formulimit